

Anketa e Arsimit të të Rriturve

Tiranë, më 10 Maj 2018: INSTAT publikon për herë të parë rezultatet e Anketës së Arsimit të të Rriturve 2017, e cila i referohet popullsisë së moshës 25-64 vjeç. Objekt kryesor i kësaj ankete, është studimi i aktiviteteve të të mësuarit gjatë gjithë jetës (arsimi zyrtar, jo-zyrtar ose trajnime dhe të mësuarit informal¹). Anketa siguron informacion mbi karakteristikat e trajnimeve, vështirësitë e pjesëmarrjes, qasjen në informacion mbi mundësitë e arsimit dhe trajnimit, aftësitë mbi gjuhët e huaja, pjesëmarrja në eventet kulturore etj.

Rezultatet e Anketës së Arsimit të të Rriturve 2017 tregojnë se:

- 9,2 % e popullsisë 25-64 vjeç kanë marrë pjesë në arsimin zyrtar dhe jo-zyrtar ose trajnime;
- 9,5 % e femrave 25-64 vjeç kanë marrë pjesë në arsimin zyrtar dhe jo-zyrtar ose trajnime, kundrejt 8,8 % të meshkujve;
- 32,3 % e individëve me arsim të lartë kanë marrë pjesë në arsimin zyrtar dhe jo-zyrtar ose trajnime;
- 7 % e individëve me arsim të mesëm kanë marrë pjesë në arsimin zyrtar dhe jo-zyrtar ose trajnime;
- 67,8 % e popullsisë 25-64 vjeç kanë marrë pjesë në të mësuarin informal;
- 39,9 % e popullsisë 25-64 vjeç deklaruan se njohin të paktën një gjuhë të huaj;
- 54,6 % e popullsisë 25-64 vjeç kanë marrë pjesë në aktivitete kulturore;
- 30,7 % e popullsisë 25-64 vjeç kanë lexuar të paktën një libër gjatë kohës së lirë.

Pjesëmarrja në arsim dhe trajnim

Gjatë periudhës së marrë në studim nga kjo anketë, rreth 25* mijë persona (1,7* %) të grupmoshës 25-64 vjeç, deklaruan se kanë marrë pjesë në arsimin zyrtar. Prej tyre 81,4* % i përkasin grupmoshës 25-34 vjeç dhe 68,2* % e tyre janë me arsim të lartë.


¹ të mësuarit informal përfshin aktivitete mësimore që ndodhin në familje, vendin e punës, komunitet dhe jetën e përditshme

* tregon se vlerat publikohen me saktësi të ulët si pasojë e numrit të vogël të njësive të vrojtura

Gjatë vitit 2017 rreth 8,2 % persona të grupmoshës 25-64 vjeç, deklaruan se kanë marrë pjesë në arsimin jo-zyrtar ose trajnime. Meshkujt, të cilët kanë marrë pjesë në arsimin jo-zyrtar ose trajnime, janë 47,8 %, ndërsa femrat 52,2 %.

Pjesëmarrja në arsimin jo-zyrtar ose trajnime kryhet nga individët e grupmoshës 25-44 vjeç, të cilët përbëjnë 70,5 % të kësaj grupmoshe. Femrat kryejnë më shumë trajnime sesa meshkujt në grupmoshën 25-44 vjeç, ndërsa në grupmoshën 45-64 vjeç dominojnë meshkujt.

Fig. 1 Pjesëmarrja në arsimin jo-zyrtar sipas grupmoshës dhe gjinisë, 25-64 vjeç




Sipas rezultateve të Anketës së Arsimit të të Rriturve, rreth 4,4 % të grupmoshës 25-64 vjeç marrin pjesë në të paktën një trajnim jo-zyrtar dhe rreth 3,8 % marrin pjesë në të paktën dy ose më shumë trajnime jo-zyrtare, gjatë vitit 2017.

Pjesëmarrja në arsimin jo-zyrtar dhe trajnime sipas nivelit më të lartë të arsimit të përfunduar me sukses është si më poshtë:

- 1,6* % e individëve me arsim të ulët (Filllore, 8-9 Vjeçare);
- 6,4 % e individëve me arsim të mesëm (Gjimnaz, Shkollë e mesme teknike/profesionale);
- 29,2 % e individëve me arsim të lartë (Bachelor, Master, Doktoraturë).

Arsyeja kryesore e cila ka nxitur pjesëmarrjen në arsimin jo-zyrtar dhe trajnime është për të kryer punën e tyre sa më mirë, 54,7 %, ndjekur nga arsyeja për të rritur njohuritë në një fushë që i intereson, 39,1 % dhe për të përmirësuar perspektivat e karrierës, 38,2 %.

Fig. 2 Arsyet e pjesëmarrjes në arsimin jo-zyrtar, 25-64 vjeç, (%)



Nga pjesëmarrësit në arsimin jo-zyrtar ose trajnime, 41,0 % deklaruan se kanë vënë plotësisht në përdorim aftësitë/njohuritë e fituara prej tyre. Ndërkohë që 56,8 % e pjesëmarrësve parashikojnë se do të përdorin plotësisht aftësitë/njohuritë e fituara, në të ardhmen.

Rreth 62,1 % e pjesëmarrësve në arsimin jo-zyrtar ose trajnim, aftësitë dhe njohuritë e reja të fituara i kanë reflektuar në një performancë më të mirë në punën aktuale.

Pjesëmarrësit në arsimin jo-zyrtar ose trajnime që kanë marrë një çertifikatë pjesëmarrjeje janë 55,3 %.


Qasja në informacion mbi mundësitë e arsimit dhe trajnimit

Gjatë vitit 2017, 8,2 % e personave të grupmoshës 25-64 vjeç kanë kërkuar informacion mbi mundësitë e arsimit dhe trajnimit. Femrat ishin më aktive në kërkimin e informacionit mbi mundësitë e arsimit dhe trajnimit sesa meshkujt, përkatësisht 9,2 kundrejt 7,3 %.

Informacion pa pagesë mbi mundësitë e arsimit dhe trajnimit kanë marrë rreth 51,1 % e personave. Një nga qasjet kryesore të përfitimit të informacionit falas është në mënyrë të drejtëpërdrejtë me 72,5 %, nëpërmjet mediave me 34,6 %, aplikacioneve në internet me 22,9 % dhe materialeve të printuara me 23,6 %.

Referuar burimit të informacionit pa pagesë mbi mundësitë e arsimit dhe trajnimit, përqindjen më të lartë e zënë institucionet arsimore apo trajnuese me 59,1 %.

Fig. 3 Personat të cilët kanë marrë informacion falas sipas burimit të informacionit



Vështirësitë e hasura në pjesëmarrjen në arsim dhe trajnim

Sipas rezultateve të anketës, 47,8 % e popullsisë 25-64 vjeç shpreh nevojën dhe dëshirën për arsim dhe trajnim, por nuk kanë patur mundësi të marrin pjesë në to gjatë 12 muajve të fundit.

Vështirësitë kryesore për pjesëmarrjen në arsim dhe trajnim ishin kostot e larta, 62,8 %, përgjegjësitë familjare, 48,4 % dhe largësia nga vendi i kryerjes së arsimit/trainimit, 28,2 %.

Fig. 4 Vështirësitë e hasura në pjesëmarrjen në arsim dhe trajnim, (%)




Pjesëmarrja në të mësuarit informal

Rezultatet e Anketës së Arsimit të të Rriturve tregojnë se 67,8 % e popullsisë 25-64 vjeç, kanë marrë pjesë në të mësuarin informal. Meshkujt ishin më aktivë sesa femrat, përkatësisht me 69,4 % dhe 66,1 %.

Sipas nivelit arsimor kanë marrë pjesë në të mësuarin informal:


- 87,3 % me arsim të lartë;
- 71,4 % me arsim të mesëm;
- 57,8 % me arsim të ulët.

Fig. 5 Pjesëmarrja në të mësuarit informal



Metoda kryesore e përdorur për të mësuarin informal (aktivitete mësimore që ndodhin në familje, vendin e punës, komunitet dhe jetën e përditshme) është nëpërmjet medias, 84,9 %, ndjekur nga të mësuarit nëpërmjet familjes/miqve/kolegëve me 53,9 % dhe të mësuarit nëpërmjet kompjuterit me 53,3 %.


Fig. 6 Pjesëmarrja në të mësuarit informal sipas metodave të përdorura (%)



Njohuritë mbi gjuhët e huaja

Rezultatet e anketës treguan se 39,9 % e popullsisë 25-64 vjeç janë në gjendje të përdorin të paktën një gjuhë të huaj. Gjuha e huaj më e njohur është gjuha angleze me 40,0 %, ndjekur nga gjuha italiane me 27,8 % dhe gjuha greke me 22,9 %.

Fig. 7 Njohja e tre gjuhëve të huaja sipas grupmoshës



Në grupmoshën 25-34 vjeç, më shumë se gjysma njohin të paktën një gjuhë të huaj (58,9 %) ku dominon gjuha angleze ndërsa në grupmoshat 35-64 vjeç ky raport ulet në të njëjtat nivele për të treja gjuhët e përmenduar.


Pjesëmarrja në aktivitete kulturore

Gjatë vitit 2017, 45,4 % e popullsisë 25-64 vjeç deklaruan se nuk kanë marrë pjesë në asnjë aktivitet kulturor.

Frekuentuan të paktën njëherë aktivitete kulturore gjatë 2017 si më poshtë:

- 34,6 %, ambiente kulturore (muzeume, galeri arti, zona arkeologjike etj);
- 31,8 %, aktivitete sportive;
- 23,4 %, performanca live (teatër, koncert, balet, etj);
- 19,9 %, kinema.

Fig 8. Pjesëmarrja në aktivitete kulturore



Gjatë 2017, 30,7 % e popullsisë 25-64 vjeç kanë lexuar të paktën një libër gjatë kohës së lirë. Femrat tregojnë interes më të lartë në leximin e librave gjatë kohës së lirë, 35,8 % e tyre kanë lexuar të paktën një libër, kundrejt 25,6 % të meshkujve, gjatë 12 muajve të fundit.

Tab. 1 Karakteristikat demografike, niveli arsimor i aritur dhe pjesëmarrja në të mësuarit gjatë gjithë jetës

	Gjithsej (për 1000)	Pjesëmarrja në arsimi zyrtar dhe jo-zyrtar (%)	Pjesëmarrja në të mësuarit informal (%)
Gjithsej	1501,4	9,2	67,8
Meshkuj	756,7	8,8	69,4
Femra	744,7	9,5	66,1
25-34	419,9	17,3	74,0
35-44	330,3	8,6	69,7
45-54	385,6	6,1	64,8
55-64	365,6	3,5*	62,0
Cikli i ulët dhe i lartë i arsimit të detyruar	706,1	2,0*	57,8
E mesme e përgjithshme/profesionale	520,7	7,0	71,4
E lartë/Master/PhD	270,6	32,3	87,3

* tregon se vlerat publikohen me saktësi të ulët si pasojë e numrit të vogël të njëjësive të vrojtura

Tab. 2 Pjesëmarrja në të mësuarit gjatë gjithë jetës sipas llojit të arsimit, 25-64 vjeç

	Pjesëmarrja në arsimin zyrtar		Pjesëmarrja në arsimin jo-zyrtar		Pjesëmarrja në të mësuarit informal	
	N	%	N	%	N	%
Gjithsej	125.410*	1,7*	123.182	8,2	1.017.536	67,8

* tregon se vlerat publikohen me saktësi të ulët si pasojë e numrit të vogël të njëjësive të vrojtura

Tab. 3 Pjesëmarrja në arsimin jo-zyrtar sipas grupmoshës dhe gjinisë

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
25-44	36.466	50.363	86.829
45-64	22.441	13.911*	36.352

* tregon se vlerat publikohen me saktësi të ulët si pasojë e numrit të vogël të njëjësive të vrojtura

Tab. 4 Arsytet kryesore të pjesëmarrjes në arsimin jo-zyrtar

Arsyet	%
Për të kryer punën time sa më mirë	54,7
Për të rritur njohuritë/afësitë e mia në një fushë që më intereson	39,1
Për të përmirësuar prespektivat e karrierës time	38,2
Të kërkuara nga punëdhënësi ose ligji	28,0
Për të rritur njohuritë/afësitë e mia në jetën e përditshme	26,5
Për të marrë një certifikatë	21,9

Tab. 5 Vështirësitë e hasura për personat që nuk kanë marrë pjesë në arsim ose trajnim, por që dëshirojnë dhe kanë nevojë

Vështirësitë	%
Shpenzimet	62,8
Përgjegjësia familjare	48,4
Largësia	28,2
Arsye të tjera personale	23,2
Mosha	13,3
Mungesa e mbështetjes së punëdhënësit ose mungesa e mbështetjes së shërbimeve publike	13,1
Pa akses në kompjuter apo internet	10,8
Shëndeti	10,7
Parakushtet	8,7
Afati	8,3
Aktivitet i përshtatshëm për arsim apo trajnim i ofruar	8,2
Eksperienca negative të mëparshme	2,5

Tab. 6 Të mësuarit informal sipas gjinisë, moshës, nivelit arsimor të arritur dhe mënyrave të ndjekura

	Të mësuarit informal					
	Familja/miq	Materiale të printuara	Kompjuter	Media	Muzeume	Biblioteka
Gjithsej	553.702	364.884	547.771	872.230	211.425	151.356
Meshkuj	303.701	177.905	284.649	443.680	113.477	65.404
Femra	250.001	186.979	263.122	428.550	97.948	85.951
25-34	180.156	150.297	235.094	251.102	79.724	67.739
35-44	131.026	82.438	129.718	202.510	49.155	30.895
45-54	132.948	77.861	111.362	216.747	50.486	30.043
55-64	109.573	54.289	71.596	201.872	32.060	22.678
Cikli i ulët dhe i lartë i arsimit të detyruar (ISCED 0-2)	213.570	60.702	126.708	365.146	41.123	16.724*
E mesme e përgjithshme/profesionale (ISCED 3-4)	184.596	126.369	201.919	326.745	69.079	32.692
E lartë/Master/PhD (ISCED 5-8)	154.151	176.188	217.760	178.714	99.839	100.555

* tregon se vlerat publikohen me saktësi të ulët si pasojë e numrit të vogël të njësive të vrojtuar

Tab. 7 Njohuritë mbi gjuhët e huaja sipas gjinisë, moshës, nivelit arsimor të arritur dhe numrit të gjuhëve të huaja

Njohuritë mbi gjuhët e huaja				
	Asnjë	1	2	3+
Gjithsej	896.674	388.030	163.148	47.972
Meshkuj	416.409	229.429	84.045	24.755*
Femra	480.265	158.602	79.103	23.217
25-34	169.747	135.097	79.867	32.258
35-44	183.418	93.889	43.304	9.260*
45-54	264.911	90.267	25.509	**
55-64	278.598	68.778	14.467*	**
Cikli i ulët dhe i lartë i arsimit të detyruar (ISCED 0-2)	564.256	118.578	17.557*	**
E mesme e përgjithshme/profesionale (ISCED 3-4)	294.567	164.916	48.816	11.420*
E lartë/Master/PhD (ISCED 5-8)	35.540	102.796	96.775	34.315

* tregon se vlerat publikohen me saktësi të ulët si pasojë e numrit të vogël të njësive të vrojtuar

** tregon se vlerat nuk mund të publikohen si pasojë e numrit të vogël të njësive të vrojtuar

Tab. 8 Gjuhët e huaja të njohura më mirë

	N	%
Anglisht	239.903	40,0%
Italisht	166.532	27,8%
Greqisht	136.951	22,9%
Tjetër	55.765	9,3%

Tab 9. Pjesëmarrja në aktivitete kulturore sipas gjinisë, moshës, nivelit arsimor të arritur dhe llojit të aktivitetit kulturor

	Teatër/ koncert/opera			Kinema			Ambjente kulturore			Aktivitete sportive		
	1-6 herë	Më shumë se 6 herë	Asnjëherë	1-6 herë	Më shumë se 6 herë	Asnjëherë	1-6 herë	Më shumë se 6 herë	Asnjëherë	1-6 herë	Më shumë se 6 herë	Asnjëherë
Gjithsej	292.588	57.862	1.147.490	236.967	61.748	1.199.309	449.821	68.301	977.250	321.058	155.788	1.020.908
Meshkuj	138.850	28.993	586.838	127.179	31.761	595.399	242.616	32.180	477.862	245.499	132.175	378.304
Femra	153.738	28.869*	560.652	109.788	29.987	603.910	207.205	36.122	499.388	75.559	23.613	642.604
25-34	116.063	23.917*	278.961	102.359	37.305	279.277	163.677	29.361*	225.904	117.960	80.690	221.280
35-44	67.725	**	252.510	55.592	**	266.015	104.216	11.618*	212.879	74.565	32.786	222.171
45-54	64.003	9.098*	311.614	50.930	8.005*	325.781	94.676	17.188*	272.852	74.112	24.612	285.158
55-64	44.796	15.009*	304.405	28.086	**	328.236	87.252	10.133*	265.615	54.421	17.700*	292.299
Cikli i ulët dhe i lartë i arsimit të detyruar (ISCED 0-2)	52.502	13.115*	638.183	46.027	10.605*	646.825	119.820	13.358*	568.714	108.049	37.304	558.896
E mesme e përgjithshme/profesionale (ISCED 3-4)	105.375	14.827*	399.313	80.246	15.770*	423.926	169.248	22.993	327.080	127.811	67.229	324.410
E lartë/Master/PhD (ISCED 5-8)	134.469	29.919*	106.183	110.695	33.988	125.890	159.127	31.950	79.029	85.198	49.870	134.934

* tregon se vlerat publikohen me saktësi të ulët si pasojë e numrit të vogël të njësive të vrojtuar

** tregon se vlerat nuk mund të publikohen si pasojë e numrit të vogël të njësive të vrojtuar

Tab. 10 Gazeta dhe libra të lexuar sipas gjinisë, moshës, nivelit arsimor të aritur dhe shpeshtësisë

	Gazeta					Libra			
	Çdo ditë	Të paktën një herë në javë	Të paktën një herë në muaj	Më pak se një herë në muaj	Asnjëherë	Asnjë	Më pak se 5	5 deri ne 10	10+
Gjithsej	583.196	369.732	213.155	127.589	205.275	1.033.537	320.873	102.537	33.931
Meshkuj	355.800	187.281	90.909	38.654	83.361	559.898	131.579	49.000	12.290*
Femra	227.396	182.451	122.247	88.935	121.914	473.639	189.294	53.537	21.641*
25-34	176.808	91.363	60.664	39.422	51.673	237.127	126.033	43.335	**
35-44	118.702	94.669	42.659	24.822	48.804	239.797	65.449	13.978*	**
45-54	149.075	99.706	49.080	34.332	52.626	280.149	68.554	26.833	7.847*
55-64	138.610	83.995	60.752	29.013	52.172	276.464	60.837	18.390*	**
Cikli i ulët dhe i lartë i arsimit të detyruar (ISCED 0-2)	176.512	194.490	119.788	66.838	147.493	609.356	72.190	14.871*	**
E mesme e përgjithshme/profesionale (ISCED 3-4)	239.976	130.409	62.794	42.221	44.789	358.433	119.489	31.226	**
E lartë/Master/PhD (ISCED 5-8)	166.467	44.834	28.564	18.529*	11.191*	63.321	127.568	56.439	22.128*

* tregon se vlerat publikohen me saktësi të ulët si pasojë e numrit të vogël të njësive të vrojtuar

** tregon se vlerat nuk mund të publikohen si pasojë e numrit të vogël të njësive të vrojtuar

Metodologjia

Anketa e arsimit të rriturve u krye në vitin 2017 në periudhën Maj-Qershor. Periudha referencë ishte 12 muaj e fundit nga momenti i intervistimit. Anketa u krye me pyetësorë letër dhe me anketues të trajnuar specifikisht.

Dizenjimi i kampionit

Anketa e Arsimit të Rriturve përfshin një kampion prej 5.264 njësi ekonomike familjare. Kampioni është zgjedhur me short duke përdorur zgjedhjen me dy hapa. Si bazë zgjedhje shërbyen të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave Tetor 2011. Në fazën e parë u zgjodhën zonat e censurit dhe në fazën e dytë njësitë ekonomike familjare që do të anketohen brenda secilës ZC (Zonë Censuri).

Një individ i moshës 25-64 vjeç, është zgjedhur rastësisht nga intervistuesi, për çdo njësi ekonomike familjare të zgjedhur, duke përdorur të njëjtën metodë të ndjekur edhe në anketat e tjera të kryera pranë familjeve.

Në fazën e parë janë përzgjedhur 440 ZC duke përdorur metodën e kampionimit rastësor të stratifikuar. Zonat e censurit do të zgjidhen rastësisht për çdo stratë, respektivisht për 12 strata (12 qarqe, sipas shkallës së urbanizimit: urban/rural) duke përdorur kampionim sistematik nga një listë e orientuar gjeografike për të garantuar përfaqësimin e zonave brenda qarqeve. Numri i ZC-ve të zgjedhura në çdo stratë është llogaritur në mënyrë të tillë që numri i NJEF-ve të përzgjedhura për stratë në (fazën e dytë) të mbetet proporcional me madhësinë. Për çdo ZC u zgjodhën respektivisht 12 NJEF për tu intervistuar. Familjet kolektive janë përjashtuar nga kampionimi, pasi nuk janë pjesë e fushës së studimit të Anketës së Arsimit të Rriturve. INSTAT do të ndjek rekomandimet e EUROSTAT-it dhe nuk do të lejojë zëvendësimin e NJEF-ve që nuk do të përgjigjen.

Përkufizime

Arsimi zyrtar: Është përcaktuar si arsimit i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar, përmes institucioneve publike dhe atyre private, të njohur (liçensuar nga autoriteti kombëtar arsimor) – në tërësinë e tyre - përbëjnë sistemin arsimor zyrtar të një vendi. Programet e arsimit zyrtar janë të njohura si të tilla nga autoritetet përkatëse të arsimit kombëtar, ato ekuivalente ose vartëse të tij. Arsimit zyrtar konsiston më tepër në arsimin që fillon nga klasa e parë dhe vazhdon rregullisht vit pas viti, kryesisht në sistemin pa shkëputje nga puna full- time (përpara se të bëhen pjesë e tregut të punës), në atë profesional, arsimin për nevoja të veçanta dhe disa pjesë të arsimit për të rritur, shpesh janë të njohura si pjesë e sistemit arsimor zyrtar.

Arsimi jo zyrtar: Është përcaktuar si arsimit i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar nga një ofrues i arsimit. Karakteristika përcaktuese e arsimit jo-zyrtar njihet si një shtesë, dhe/ose alternativë plotësuese e arsimit zyrtar në kuadër të procesit të mësuarit gjatë gjithë jetës së individëve. Shpesh garanton të drejtën e qasjes në arsim për të gjithë, shërben për njerëz të gjitha moshave, por nuk strukturohet detyrimisht në mënyrë të vazhduar; mund të jetë i shkurtër në kohëzgjatje dhe/ose me

intensitet të ulët, në mënyrë tipike ofrohet në formën e kurseve të shkurtra, workshope apo seminare. Arsimi jo zyrtar çon kryesisht në kualifikime që nuk janë të njohura si zyrtare nga autoritetet kombëtare përkatëse të arsimit, ose ato nën varësinë e tyre, ose nuk njihen fare. Ky lloj arsimi mund të mbulojë programet që kontribuojnë për të rritur, për fëmijët jashtë shkolle, si dhe programet për aftësitë jetësore, aftësitë e punës dhe zhvillimin social kulturor.

Arsimi informal: Është përcaktuar si i qëllimshëm, por më pak i organizuar dhe më pak i strukturuar se arsimi zyrtar ose jo zyrtar. Të mësuarit informal mund të përfshijë aktivitete mësimore që ndodhin në familje, vendin e punës, komunitet dhe jetën e përditshme, në bazë të iniciativës së vetë personit, drejtuar nga familja apo shoqëria.

ISCED 2011 është klasifikimi i përdorur në përpunimin e të dhënave dhe llogaritjen e indikatorëve të arsimit, i përbërë nga këto nivele sipas programeve arsimore:

- Niveli 0 - Arsimi parashkollor – çerdhe / kopshte
- Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë
- Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë
- Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnaz / Profesional
- Niveli 4 - Arsimi pas të mesme por jo i lartë
- Niveli 5 - Arsimi i lartë cikël i shkurtër
- Niveli 6 – Bachelor ose ekuivalent
- Niveli 7 - Master ose ekuivalent
- Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

Nivelet arsimore:

- Cikli i ulët dhe i lartë i arsimit të detyruar (ISCED 0-2)
- E mesme e përgjithshme/profesionale (ISCED 3-4)
- E lartë/Master/PhD (ISCED 5-8)